



KËSHILLI QARKUT  
TIRANË

Nr. 1221 Prot.

Tiranë më 2/6/2016

Lënda: Urdhër për miratimin e programit të transparencës

Drejtuar: **Drejtorisë së Koordinim Zhvillimit**

**Këtu**

Në mbështetje Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe në zbatim të neneve 4,5,6,7,19 të Ligjit Nr.119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, në Urdhërin Nr.14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për miratimin e programit të transparencës”,

**Urdhëroj:**

**I.** Miratimin e Programit të Transparencës sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur këtij Urdhëri.

**II.** Miratimin e standartit të formatit dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas lidhjes Nr.2, bashkëlidhur.

**III.** Miratimin e modelit të kërkesës dhe përgjigjes “Për dhënie të informacionit/dokumentacionit që do të përdoret nga institucioni i Këshillit të Qarkut, sipas lidhjes Nr.3 bashkëlidhur.

**IV.** Miratimin e akteve shkresore që do të përdoren nga institucioni i Këshillit të Qarkut për vendimmarrjet sipas lidhjes Nr.4 bashkëlidhur:

- a) Për refuzimin e formë së kërkuar (neni 14/4);
- b) Për zgjajen e afatit (15/3);
- c) Për rishikimin e dokumentave të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit (17/5)

**V.** Botimin e programit të transparencës në një fushë të caktuar në webfaqen e Këshillit të Qarkut Tiranë dhe në ambjentet e zyrës së pritjes së publikut.

VI. Caktimin e *Z. Erion Habilaj* dhe *Znj. Irida Qafoku* koordinatorë të programit të transparencës.

VII. Ngarkohet për ndjekjen e procedurës përkatëse ligjore në zbatim të këtij Urdhëri, Drejtoria e Koordinim Zhvillimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

**Aldrin Dalipi**

